



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 407/1 Prot.

Tiranë, më 06.03.2024

V E N D I M

Nr. 59, Datë 06.03.2024

Bazuar në nenin 32/1/b dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi ankesën nr.183, datë 25.09.2023, e znj. M. Z, në cilësinë e përfaqësueses ligjore të nipërve të saj E dhe E. Z, kundër Bashkisë Tiranë, me pretendimin për diskriminim, për shkak të përkatësisë prindërore dhe gjendjes familjare.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Në bazë të Vendimit nr.7719, datë 14.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është caktuar si kujdestare e nipërve të saj E dhe E. Z, 11 dhe 9 vjeç. Mamaja e fëmijëve ka vdekur ndërsa babai (i biri i ankueses) i tyre është në burg. Fëmijët kanë përfituruar bursë që janë jetim në total 106 mijë lekë të vjetra. Ka që në prill të vitit 2023 që kërkon ti japin bursën e fëmijëve por që nuk ja japin. Ka vajtur te Ministria e Arsimit dhe Sportit për tu interesuar dhe i kanë thënë që për këtë problem ti drejtohet Bashkisë Tiranë. Në Bashkinë Tiranë i kanë thënë që të bëjë një ankesë, me vonë i kanë thënë që nuk kanë lekë, në momentin që do ti kenë në gjendje do të jua japin pasi fëmijët janë përfitues. Ndërkohë ankuesja shprehet se ato lekë i ka të domosdoshme për të rritur fëmijët, marrin 90 mijë lekë të vjetra nga vendimi i gjykatës, pensioni i saj është 104 mijë lekë të vjetra, pensioni i invalidit të burrit 165 mijë lekë të vjetra dhe me këto të ardhura është e pamundur që të jetojnë 4 persona.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të përkatësisë prindërore dhe gjendjes

familjare, si dhe përfshirjen e nipërve të saj në listën e përfituesve për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Sa më sipër, ankesa u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” të ndryshuar. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 33 të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.1040/1 prot, datë 02.10.2023, Komisioneri kërkoi informacion nga Bashkia Tiranë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, në lidhje me ankesën e mësipërme, si më poshtë:
 - Informacion nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, lidhur me situatën e pretenduar nga ana e ankueses.
 - Informacion përse fëmijët në kujdestari të subjektit ankues nuk kanë përfituar nga parashikimet e VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022, “Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar”, të ndryshuar.
 - Informacion lidhur me numrin e fëmijëve që kanë përfituar nga parashikimet e VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022, “Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar”, të ndryshuar, duke specifikuar kriterin për të cilin kanë përfituar, për secilin rast.
 - Si dhe çdo shpjegim apo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

Me shkresën nr.34021/1 prot., datë 11.10.2023 ka kthyer përgjigje Bashkia Tiranë, duke sqaruar se: *Bashkia Tiranë në respektim të çdo afati ligjor të VKM nr.511, datë 27.07.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike", të ndryshuar, (në vijim referuar "VKM nr. 666, datë 10.10.2019") realizoi njoftimin për fillimin e procedurave të aplikimit për trajtimin me bursë nga fondi i bursave të shtetit për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, referuar kriterëve dhe kushteve ligjore që duhet të plotësojnë qytetarët për të përfituar këtë bursë, si dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim.*

Sa më sipër, ju bëjmë me dije gjithashtu se, me synim zbatimin me efikasitet maksimal të procesit të përcaktimit të kërkesave, kriterëve, procedurave dhe afateve për aplikim për bursa sipas kriterëve të përcaktuara, nëpërmjetë shkresës me nr.35617/1 prot., datë 25.10.202, drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, kemi përcjellë kërkesën për rritjen e numrit të kuotave për bursa

për vitin shkollor 2022-2023, referuar aplikimeve të viteve të kaluara si dhe shtesave të kategorive përfituese të miratuara në VKM e sipërcituar.

Bashkia Tiranë ka shprehur vazhdimisht zyrarisht dhe jo vetëm, por dhe me takime dhe tryeza ndërinstucionale se mbetet e angazhuar dhe e hapur për të bashkëpunuar në kuadër të rishikimit dhe rivlerësimit të formulimit dhe përcaktimit të kritereve dhe kategorive përfituese të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019.

Në vijim të këtij procesi, ndodhur në limit të afateve ligjore, Bashkia Tiranë ka vijuar me miratimin e 1200 nxënës të arsimit parauniversitar të përgjithshëm në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa, brenda planit të miratuar brenda vitit shkollor 2022-2023, si më poshtë:

- *Vendimi i Këshillit Bashkiak Tiranë nr.133, datë 23.12.2022 "Për miratimin e listave të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa dhe pagesa, për vitin shkollor 2022-2023".*
- *Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë nr.13, datë 25.01.2023 "Për miratimin e listave të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa dhe pagesa, për vitin shkollor 2022-2023".*

Në lidhje me kërkesën për informim mbi arsyen e mospërfitimit të bursës së fëmijve të subjektit ankues, referuar VKM nr.511, datë 27.07.2022, ju sqarojmë se, dosjet e aplikimit të nxënësve E dhe E. Z, janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social.

Në vijim të gjithë këtij procesi, ndodhur në kushtet kur numri i aplikimeve të cilat plotësojnë kriteret dhe kanë aplikuar me dokumentacion të rregullt është më i lartë se numri i kuotave në planin e miratuar për vitin 2022-2023, Bashkia Tiranë është drejtuar me kërkesë zyrtare me nr.5460 prot., datë 07.02.2023, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për miratimin e rritjes së kuotave për bursa për nxënësit e arsimit të përgjithshëm të shkollave të Tiranës si dhe shtyrjen e afatit për miratim, me qëllim mbështetjen e të gjithë qytetarëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në VKM.

Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion mbi numrin e fëmijëve që kanë përfitur referuar parashikimeve të VKM nr. 511, datë 27.07.2022, sqarojmë se kuotat për Bashkinë Tiranë për vitin shkollor 2022-2023 nuk janë rritur, janë 1200 (njëmijë e dyqind) bursa, njësoj me vitin e kaluar shkollor, pavarësisht ndryshimeve dhe shtesave të kategorive përfituese të miratuara me VKM nr. 511, datë 27.07.2022, të cilat nuk ishin të parashikuara në kuotat para ndryshimeve ligjore. Bashkëlidhur do të gjeni vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë, me listat e miratuara të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, të detajuar sipas kritereve, si me poshtë:

- *Vendimi i Këshillit Bashkiak Tiranë nr.133, datë 23.12.2022 "Për miratimin e listave të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa dhe pagesa, për vitin shkollor 2022-2023".*

- *Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë nr.13, datë 25.01.2023 "Për miratimin e listave të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa dhe pagesa, për vitin shkollor 2022-2023".*

Bashkëlidhur do të gjeni praktikën shkresore të sipërcituar në këtë shkresë, duke ju parashtruar se Bashkia Tiranë mbetet e hapur për bashkëpunim.

2. Shkresa nr.34021/1 prot., datë 11.10.2023 e Bashkisë Tiranë iu përcoll për parashtrime ankueses znj. M. Z.
3. Me shkresën nr. 1113 prot., datë 16.10.2023 pranë Komisionerit, është administruar ankesa e znj. M. Z, në lidhje me parashtrimet e saj për qëndrimin e mbajtur nga Bashkia Tiranë sipas kërkesës nr.34021/1 prot., datë 11.10.2023, në të cilën ndër të tjera shpjegon se: *Fëmijët e kanë përfituar një vit më parë bursën dhe kushtet për këta fëmijë nuk kanë ndryshuar për të mos e përfituar dhe këtë vit. Dokumentacioni i dorëzuar nga ana ligjore është i plotë dhe përgjigja se jemi jashtë afatit nuk ka lidhje me ne. Ju lutem jam një gjyshe po mbaj dy fëmijë ekselent ata e përfitojnë, janë dhe jetim nga nëna dhe babain e kanë në spitalin e burgut. Në këto kushte kërkoj bursën e fëmijve jetim dhe të mos diskriminohen nga Bashkia Tiranë të mos abuzohet në përzgjedhjen e përfituesve të bursës.*
4. Me shkresën nr.1040/4 prot., datë 19.10.2023 të Komisionerit, është kërkuar informacion shtesë nga Bashkia Tiranë, si më poshtë:
 - Informacion nëse nxënësit E. Z dhe E. Z, kanë qenë përfitues të bursës për vitin mësimor 2022-2023 nga parashikimet e VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022, "Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar", të ndryshuar, sikurse shprehet ankuesja.- Nëse po, të shpjegohen shkaqet ligjore të cilat kanë shërbyer për mospërfshirjen e tyre në listat përfituese për vitin mësimor 2023-2024.
 - Cilat janë shkaqet ligjore që kanë ndryshuar në këtë vit, pasi sipas znj. Z, fëmijët janë jetim nga nëna ndërsa babain e kanë në burg, kriteret të cilat nuk kanë ndryshuar, kushte të cilat kanë qenë dhe një vit më parë.
 - Informacionin se cilat janë kriteret për përzgjedhjen aplikantëve përfitues të bursës, pasi në informacionin e dërguar nga ana juaj sqaroni që numri i nxënësve që plotësojnë kushtet për ta përfituar këtë bursë është më i madh se kuotat e parashikuara prej 1200 nxënës dhe si bëhet përzgjedhja e tyre.
 - Si dhe çdo shpjegim apo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.
5. Me shkresën nr.6165/1 prot., datë 18.10.2023 (administruar pranë Komisionerit me nr. 1040/3 prot., datë 19.10.2023), Ministria e Arsimit dhe Sportit, ka kthyer përgjigje, duke dhënë shpjegime në lidhje me rastin objekt shqyrtimi si dhe ka vënë në dispozicion kopje të

korespondencës shkresore me Bashkinë Tirane dhe me subjektin ankues. Ndër të tjera, Ministria e Arsimit dhe Sportit shprehet:

1. Sipas vendimit nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe për përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, i ndryshuar, (në vijim referuar “VKM nr. 666, datë 10.10.2019”) nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera nga buxheti i miratuar për ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin profesional.

Për përfitim të bursave dhe përfitimeve të tjera nxënësit duhet të ndjekin arsimin parauniversitar, me kohë të plotë, pranë institucioneve arsimore publike, si dhe miratimi i tyre bëhet brenda kuotave dhe sipas kriterëve të cilat grupohen në katër kategori, të përcaktuara në pikat 2.1-2.4 të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, i ndryshuar, përkatësisht: 2.1 kriteri ekonomik; 2.2 kriteri i rezultateve të arritura; 2.3 kriteri joekonomik dhe 2.4 kriteri i degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm.

Në pikën 30 të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, i ndryshuar, parashikohet: “30. Ministria përgjegjëse për arsimin, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar, të parashikuar në pikën 2, të këtij vendimi, pa përfshirë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale, jep jo më pak se 1200 (një mijë e dyqind) bursa”.

2 Ministria e Arsimit dhe Sportit (në vijim referuar MAS), në zbatim të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, i ndryshuar, i është drejtuar bashkive me shkresat e poshtëshënuara:

2.1 Me shkresën nr. 6478 prot., datë 07.10.2022, i ka njoftuar për planifikimin e fondeve nga ana e saj për bursa për nxënësit duke i kërkuar bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës ndërinstitutionale për shpalljen/publikimin e kërkesave, kriterëve, procedurave dhe afateve për aplikimin për bursa nga të gjithë subjektet e interesuar dhe sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 666, datë 10.10.2019, e ndryshuar. Gjithashtu i është kërkuar që të dërgojnë në MAS parashikimin/planifikimin për numrin e bursave që përfitojnë nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar, me kohë të plotë, në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2022-2023, brenda datës 31.10.2022.

2.2 Me shkresën nr. 6478/40, datë 01.11.2022, i është dërguar plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, 2022-2023, për 29 bashki.

2.3 Me shkresat nr. 248 prot., 12.01.2023 dhe nr. 2924 prot., datë 04.05.2023, MAS ka kërkuar informacion në lidhje me bursat e miratuara me vendim të këshillit bashkiak të njësive të qeverisjes vendore për vitin shkollor 2022-2023, në kuadër të raportimit çdo tre mujor, për numrin e nxënësve të arsimit parauniversitar që trajtohen me bursa dhe me kuota ushqimore në konvikte si dhe për fondet buxhetore të shpenzuara.

3. Bashkia Tiranë me shkresën nr. 35617/1 prot., datë 25.10.2022, drejtuar MAS, ka parashikuar që numri i aplikimeve të cilat mund të rezultojnë me dokumentacion të rregullt dhe plotësojnë kriteret do të jetë rreth 3500. Në shkresë kërkohet bashkëpunimi për një interpretim shterues mbi procedurën dhe kërkesat ligjore që duhet të plotësojnë nxënësit për kriterin 2.1 (c).

MAS, me shkresën nr. 6478/57 prot., datë 01.12.2022 me lëndë “Kthim përgjigje”, e ka sqaruar Bashkinë Tiranë lidhur me shkronjën “c”, e nën pikës 2.1, të pikës 2, të VKM nr. 511, datë 27.07.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 666, datë 10.10.2019...”, e ka sqaruar si vijon:

Pika 1, e projektvendimit parashikon që shkronja “c”, e nën pikës 2.1, të pikës 2, të ndryshohet duke përcaktuar se do të përfitojnë bursa sipas kriterit ekonomik nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë. Ndryshimi i kësaj pike vjen në zbatim të kërkesës nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në vijim të kërkesës së subjektit “Qendra T’Reja” që e konsideron pengesë dhe diskriminuese përdorimin e togfjalëshit “braktisje shkollore”, duke lidhur përfitimin e bursave me të qenit braktisës. Për pasojë kriteri vijon të jetë i njëjtë, si vitet e kaluara, pasi vetëm terminologjia ka ndryshuar.”

MAS i ka dërguar Bashkisë Tiranë, 1800 bursa për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2022-2023, sipas shkresave nr. 6478/63 prot., datë 21.12.2022 dhe nr. 953/2 prot., datë 14.06.2023.

4. Në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit është regjistruar me nr.5875 prot., datë 19.09.2023, kërkesa e z. Klajdi Zika nëpërmjet të cilës ankohet për mostrajtimin me bursë të dy fëmijëve jetim, nxënës në shkollën "Musine Kokalari", E. Z klasa III dhe E. Z klasa V.

Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr.5875/1 prot., datë 22.09.2023, drejtuar K. Z dhe Bashkisë Tiranë ka informuar për numrin e bursave të akorduara kësaj bashkie për vitin shkollor 2022-2023. Sipas kësaj shkrese Bashkia Tiranë është institucioni i cili, në zbatim të afateve dhe kriterëve të përcaktuara në VKM nr.666, datë 10.10.2019, shqyrton dhe vlerëson aplikimet për bursë. Miratimi i nxënësve përfitues të bursës të arsimit parauniversitar bëhet me Vendim të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Tiranë. Në përfundim Ministria e Arsimit dhe Sportit është shprehur se është detyrim i Këshillit Bashkiak Tiranë të shqyrtojë rastin e z. K. Z, për miratimin e bursës për dy jetimë, sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr.666, datë 10.10.2019, të ndryshuar.

Bashkëlidhur depozitojmë kopje të dokumentacionit të poshtëshënuar:

- Shkresa e MAS nr. 6478 prot., datë 07.10.2023, "Për planifikimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2022-2023", (2 fletë).
- Shkresa e Bashkisë Tiranë drejtuar MAS, të regjistruar me nr.6478/18, nr. 953 dhe nr.953/3, (3 fletë).
- Shkresa të MAS dërguar Bashkia Tiranë, nr.6478/57/63 dhe nr.953/2, (3 fletë).

- Kërkesë e z. K. Z, regjistruar në MAS me nr. 5875 prot., datë 19.09.2023, (1 fletë).
- Kthim përgjigje e MAS me nr.5875/1 prot., datë 22.09.2023, drejtuar z. K. Z dhe Bashkisë Tiranë, (1 fletë).

6. Me shkresën nr. 1040/5 prot., datë 13.11.2023 nga Komisioneri iu kërkuan në mënyrë të përsëritur informacion Bashkisë Tiranë, kërkuar me shkresën nr. 1040/4 prot., datë 19.10.2023.
7. Me shkresën nr. 34021/3 prot., datë 14.11.2023 dhe shkresën nr.3932/1 prot., datë 20.11.2023 Bashkia Tiranë, ktheu përgjigje dhe mbajti të njëjtin qëndrim, duke informuar ndër të tjera se:

“...Bashkia Tiranë në respektim të çdo afati ligjor të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, (i ndryshuar), realizoi njoftimin për fillimin e procedurave të aplikimit për trajtimin me bursë nga fondi i bursave të shtetit për nxënësit, referuar kritereve dhe kushteve ligjore që duhet të plotësojnë qytetarët për të përfutuar këtë bursë, si dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim.

Sa më sipër, me qëllim mbështetjen e të gjithë qytetarëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në VKM e mësipërme, nëpërmjet shkresës me nr. 35617/1 prot., datë 25.10.2022, drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, kemi përcjellë kërkesën për rritjen e numrit të kuotave për bursa për vitin shkollor 2022-2023, referuar aplikimeve të viteve të kaluara si dhe shtesave të kategorive përfituese të miratuara në VKM e mësipërme.

Në vijim të këtij procesi, Bashkia Tiranë ka vijuar me miratimin e listave me 1200 nxënës të arsimit parauniversitar të përgjithshëm në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa, brenda planit të miratuar për vitin shkollor 2022-2023, si më poshtë:

- Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë Nr. 133, datë 23.12.2022 “Për miratimin e listave të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa dhe pagesa, për vitin shkollor 2022-2023”.
- Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë Nr. 13, datë 25.01.2023 “Për miratimin e listave të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa dhe pagesa, për vitin shkollor 2022-2023”.

Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion mbi mënyrën e përzgjedhjes së aplikantëve që plotësojnë kriteret ligjore për të përfutuar bursë, konkretisht si klasifikohet një numër i caktuar dhe lihen veçantë aplikime të tjera, për shkak të kuotave të pamjaftueshme të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, ju sqarojmë se, mënyra e përzgjedhjes ka qenë rendore sipas radhës së shqyrtimit dhe vlerësimit të dosjeve të aplikimit.

Gjithashtu ju sqarojmë se, Bashkia Tiranë nuk ka përjashtuar asnjë aplikant me dokumentacion të rregullt por në vijim të gjithë këtij procesi, ndodhur në kushtet kur numri i aplikimeve të cilat plotësojnë kriteret dhe kanë aplikuar me dokumentacion të rregullt është më i madh se numri i

kuotave në planin e miratuar për vitin shkollor 2022-2023, Bashkia Tiranë është drejtuar me kërkesë zyrtare me nr.5460 prot., datë 07.02.2023, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për miratimin e rritjes së kuotave për bursa për nxënësit e arsimit të përgjithshëm të shkollave të Tiranës si dhe shtyrjen e afatit për miratim, me qëllim mbështetjen e të gjithë qytetarëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në VKM.

Në lidhje me pyetjen tuaj për mospërfshirjen e tyre në listat përfituese për vitin mësimor 2023-2024 ju sqarojmë se për këtë vit mësimor ende nuk është shpallur lista fituese pasi procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimeve është në vazhdim.

Po kështu në zbatim të VKM nr.666/2019, i ndryshuar, Ministria e Arsimit dhe Sportit, ngarkohet për hartimin e planit të kuotave për çdo bashki, referuar konkretisht pikës 6, e cila shprehet se: "Ministria përgjegjëse për arsimin, në fillim të çdo viti shkollor, në konsultim me institucionet arsimore, harton planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit e arsimit paruniversitar, të cilin e dërgon në njësitë e vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se muaji tetor" dhe ende nga MAS nuk ka ardhur plani me numrin e kuotave të miratuara për Bashkinë Tiranë.

Sa më sipër, ju sqarojmë se pavarësisht kërkesave të vazhdueshme për rritje të numrit të kuotave referuar analizave tona mbi aplikimet e viteve të kaluara, të cilat kanë rezultuar me trend rritës vit pas viti, por edhe shtesave të kategorive përfituese me ndryshimet ligjore të VKM-së nr.511, datë 27.07.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat financiare dhe ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", i ndryshuar, kuotate miratuara nga MAS mbetën të pandryshuara 1200 (njëmijë e dyqind) bursa, për vitin shkollor 2022-2023.

2. Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 134, datë 29.06.2023, Komisioneri me shkresën nr. 1040/7, datë 20.11.2023 njoftoi palët, për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 04.12.2023, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe pretendimet e palëve në proces.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 12.12.2023, për arsye të shtyrjes së saj nga ana e Komisionerit dhe u zhvillua me praninë e palëve në proces: ankuesja znj. M. Z dhe përfaqësueses së Bashkisë Tiranë, znj. A. L.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Në vijim gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e Bashkisë Tiranë theksoi se: *“Përzgjedhja e përfituesve është rastësore dhe sipas momentit të hedhjes në database që mban Bashkia në kohën kur ato dërgohen nga shkollat përkatëse. Detyrimi i përfaqësuesve të shkollave lidhet vetëm me mbledhjen e dokumentacionit dhe përcjelljen e tij në njësitë e vetëqeverisjes vendore”.*

Në përfundim të seancës, nga ana e Komisionerit u kërkua që Bashkia Tiranë të na vinte në dispozicion informacionin lidhur me shkresën nëpërmjet të cilës janë dërguar nga Shkolla "Musine Kokalari" dokumentacioni për këta nxënës, listën me numrin e aplikantëve përfitues sipas VKM-së 666/2019, të ndryshuar, për bursat e vitit 2022-2023.

Me shkresën nr.1040/9 Prot., datë 13.12.2023 pranë Komisionerit, është administruar shkresa nr.135 prot., datë 12.12.2023 me lëndë "Vërtetim" e Shkollës 9-vjeçare "Musine Kokalari", Tiranë. Me anë të shkresës vërtetohet se, me shkresën nr.91 prot., datë 21.10.2023, me lëndë: *"Përcjellje e dosjeve të aplikimit për bursa të nxënësve të shkollës "Musine Kokalari", për vitin shkollor 2022-2023, drejtuar Bashkia Tiranë, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Sociale, janë listuar edhe emrat e nxënësve:*

1. E. G. Z. (nr.22) dhe

2. E. G. Z. (nr.29)

Lidhur me plotësimin e kërkesave të parashtruara gjatë seancës dëgjimore, përmes *e-mail-it*¹ datë 09.01.2024, Komisioneri rikërkoi nga Bashkia Tiranë, vendosjen në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar gjatë seancës dëgjimore të datës 12.12.2023.

Në përgjigje të *e-mail-it*² datë 09.01.2024, nga ana e Bashkisë Tiranë u kthye përgjigje me *e-mail-it*² datës 10.01.2024, ku sqaron se: *Në lidhje me trajtimin e ankesës së znj. M. Z, ju sqarojmë dhe njëherë se aplikimet për bursa për nxënësit E dhe E. Z, janë shqyrtuar dhe trajtuar pa asnjë formë diskriminimi nga Bashkia e Tiranës, e cila në zbatim të afatave ligjore të Vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, i ndryshuar”, Bashkia e Tiranës ka vijuar me miratimin e listave me 1200 nxënës të arsimit parauniversitar të përgjithshëm në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa, brenda planit të miratuar për vitin shkollor 2022 – 2023, të përzgjedhur në mënyrë rastësore sipas radhës së shqyrtimit dhe vlerësimit të dosjeve të aplikimit. Gjithashtu ju sqarojmë dhe njëherë se, Bashkia Tiranë, nuk ka përjashtuar asnjë aplikant me dokumentacion të rregullt, por në vijim të gjithë këtij procesi, ndodhur në kushtet kur numri i aplikimeve të cilët plotësojnë kriteret dhe kanë aplikuar me dokumentacion të rregullt është më i madh se numri i kuotave në planin e miratuar për vitin shkollor 2022-2023 nga MAS, konkretisht për vitin 2022-2023 rezultoi 494 kuota më pak se numri i aplikimeve me dokumentacion të rregullt, Bashkia Tiranë i është drejtuar në vazhdimësi me kërkesa zyrtar, Ministrisë së Arsimit*

¹ Dërguar nga ana e Komisionerit.

² Dërguar nga ana e znj. A. L.

dhe Sportit, për miratimin e rritjes së numrit të kuotave për bursa për nxënësit e arsimit të përgjithshëm të shkollave të Tiranës si dhe shtyrjen e afatit për miratim, me qëllim mbështetjen e të gjithë qytetarëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në VKM e sipërcituar. Ju bejme me dije se pavaresisht kërkesave të Bashkisë Tiranë drejtuar MAS, për domosdoshmërinë e rritjes së planit të kuotave për bursa, për zgjidhjen e situatës së kuotave të pamjaftueshme, përsëri për vitin shkollor 2023-2024, numri i kuotave për Bashkinë Tiranë ka qenë vetëm 1300, i cili rezultoi i pamjaftueshëm për të mbuluar qytetarët që plotësojnë kriteret e parashikuara në VKM-në e sipërcituar. Ndoshtur në këto kushte, me qëllim evitimin e situatës së vitit të kaluar shkollor dhe mbështetjen e të gjithë aplikantëve që plotësojnë kriteret me dokumentacion të rregullt, Bashkia Tiranë ka parashikuar të mbulojë me fondet e saj në PBA 2024-2026, kuotat e pamjaftueshme të miratuara nga MAS për vitin shkollor 2023-2024. Bëjmë me dije se për vitin mësimor 2023-2024, Bashkia Tiranë ka realizuar përhshirjen në listat fituese të gjitha aplikimet që plotësuan kriteret me dokumentacion të rregullt, pjesë e të cilave janë dhe nxënësit E dhe E. Z.

Me shkresëm nr. 85 prot., datë 15.01.2024 të Komisionerit, u kërkua nga Bashkia Tiranë, informacioni i mëposhtëm:

- Në bazë të cilit kriter, nxënësit E. Z dhe E. Z, kanë qenë përfitues të bursës për vitin mësimor 2021-2022 nga parashikimet e VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022, "Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar", të ndryshuar, të shoqëruar me listën e miratuar nga Këshilli Bashkiak Tiranë.
- Në përgjigjet tuaja shpreheni se nxënësit E. Z dhe E. Z janë përfitues të bursës dhe për vitin mësimor 2023-2024, na informoni në bazë të cilit kriter janë përzgjedhur përfitues dhe nëse është miratuar lista e përfituesve nga Këshilli Bashkiak Tiranë për këtë vit, nëse po të na vini në dispozicion listën.

Me shkresën nr.1940/1 prot., datë 26.01.2024 Bashkia Tiranë është përgjigjur si më poshtë vijon: *Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion mbi kriterin me të cilin janë shpallur fitues të bursës për vitin shkollor 2021-2022 nxënësit E. Z dhe E. Z, ju sqarojmë se dosjet e aplikimit të nxënësve E dhe E. Z, janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga Drejtoria e Politikave Lokale Arsimore dhe referuar dokumentacionit të depozituar për aplikim, kanë plotësuar kushtet e përfitimit për kriterin 2.3/b "Nxënësit që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate". (Bashkëlidhur do të gjeni dokumentacionin e aplikimit të nxënësve të sipërcituar dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë nr.172, datë 24.12.2021 "Për miratimin e listave të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa dhe pagesa, për vitin shkollor 2021-2022")*

Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion mbi kriterin me të cilin janë shpallur fitues të bursës për vitin shkollor 2023-2024 nxënësit E. Z dhe E. Z, ju sqarojmë se dosjet e aplikimit të nxënësve E. dhe E. Z, janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga Drejtoria e Politikave Lokale Arsimore dhe referuar dokumentacionit të depozituar për aplikim, kanë plotësuar kushtet e përfitimit për kriterin 2.3/b "Nxënësit që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate".

Bashkëlidhur do të gjeni dokumentacionin e aplikimit të nxënësve të sipërcituar dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë nr.130, datë 22.12.2023 "Për miratimin e listave të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa dhe pagesa, për vitin shkollor 2023-2024").

Gjithashtu ju sqarojmë se, edhe për vitin shkollor 2023-2024 ka rezultuar se numri i aplikimeve të nxënësve të arsimit të përgjithshëm parauniversitar, të cilat plotësojnë kriteret me dokumentacion të rregullt, ka qenë më i madh se numri i kuotave në planin e miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, 1300 bursa për Bashkinë Tiranë. Ndodhur në këto kushte, në të cilat efektet financiare për 387 aplikime të vlerësuara përfituese me dokumentacion të rregullt nuk mbuloreshin me transfertën e kushtëzuar të MAS, Bashkia Tiranë me qëllim evitimin e situatave të vitit të kaluar shkollor në mbështetjen e të gjithë qytetarëve që plotësuan kriteret e parashikuara në VKM, ka miratuar mbulimin e efekteve financiare për këto aplikime, me fondet e Bashkisë së Tiranës me Vendim të Këshillit Bashkiak, pasi u parashikua dhe miratua PBA 2024-2026.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të

shqyrtimit të çështjes.

Në bazë të informacionit të administruar nga ana e Komisionerit rezulton se, znj. M Z, në bazë të Vendimit nr.7719, datë 14.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është caktuar, kujdestare e fëmijëve të mitur (nipi dhe mbesa e saj), E dhe E. Z.

Referuar certifikatës së gjendjes familjare të datës 27.07.2021, fëmijët e mitur E dhe E. Z figurojnë të regjistruar si pjestarë të familjës, e cila përbëhet prej 4 personash.(Gjyshi, gjyshja, nipi dhe mbesa. E. Z ka lindur në datën 09.04.2013 dhe E. Z ka lindur në 26.11.2014.

Në bazë të certifikatës së vdekjes datë 21.10.2019, rezultoi që nëna e dy fëmijëve të mitur M. V, ka vdekur në datën 09.10.2018. Me Vërtetimin nr.3317 prot., datë 23.10.2023 të Njesisë Administrative nr.6, rezulton e provuar se M. B. Z, është banore i kësaj njësie dhe nuk trajtohet me ndihmë ekonomike apo pagesë paaftësie.

Në datën 31.05.2023, znj. M. Z, ka plotësuar një Formular Aplikimi nr.M-11862 prot., për marrjen e informacionit në lidhje me heqjen e bursave të nipërve të saj E. dhe E. Z për vitin shkollor 2022-2023. Formulari është i shoqëruar me dy Dëftesat për klasat respektive të nipërve të saj ekselent, për përfitimin e bursave të shtetit për nxënësit.

Në bazë të shkresës nr. M-11862 prot., datë 20.06.2023 nga Drejtoria e Politikave Lokale Arsimore, Bashkia Tiranë është kthyer përgjigje, ku ndër të tjera ka sqaruar se, nga ana e Bashkisë Tiranë, është kërkuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, miratimi i rritjes së numrit të kuotave si dhe shtyrjes së afatit për miratim, me qëllim mbështetjen e të gjithë qytetarëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në VKM nr.666, datë 10.10.2029 "Për kuotat financiare të

ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimine bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet publike”, i ndryshuar.

Në bazë të shkresës nr.5875/1 prot., datë 22.09.2023, ka kthyer përgjigje dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, e cila është shprehur se, është detyrim i Këshillit Bashkiak Tiranë, të rishqyrtojë rastin e z. K Z³, për miratimin e bursës për dy fëmijët jetim, sipas kriterëve të parashikuara në VKM nr.666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimine bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet publike”, i ndryshuar.

Referuar përgjigjes së dhënë Komisionerit nga Bashkia Tiranë, ndër të tjera ky institucion është shprehur se: *Në lidhje me trajtimin e ankesës së znj. M Z, ju sqarojmë dhe njëherë se aplikimet për bursë për nxënësit E dhe E Z, janë shqyrtuar dhe trajtuar pa asnjë formë diskriminimi nga Bashkia e Tiranës, e cila në zbatim të afatave ligjore të Vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, i ndryshuar”, Bashkia e Tiranës ka vijuar me miratimin e listave me 1200 nxënës të arsimit parauniversitar të përgjithshëm në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa, brenda planit të miratuar për vitin shkollor 2022 – 2023, të përzgjedhur në mënyrë rastësore sipas radhës së shqyrtimit dhe vlerësimit të dosjeve të aplikimit.”*

Ndërkohë referuar kthimit të përgjigjes me nr.39932/1 prot., datë 20.11.2023, Bashkia Tiranë është shprehur: *“Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion mbi mënyrën e përzgjedhjes së aplikantëve që plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar bursë, konkretisht si klasifikohet një numër i caktuar dhe lihen veçantë aplikime të tjera, për shkak të kuotave të pamjaftueshme të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, ju sqarojmë se, mënyra e përzgjedhjes ka qenë rendore sipas radhës së shqyrtimit dhe vlerësimit të dosjeve të aplikimit.”*

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e Bashkisë Tiranë u shpreh se: *“Përzgjedhja e përfituesve është rastësore dhe sipas momentit të hedhjes në database që mban Bashkia në kohën kur ato dërgohen nga shkollat përkatëse. Detyrimi i përfaqësuesve të shkollave lidhet vetëm me mbledhjen e dokumentacionit dhe përcjelljen e tij në njësitë e vetëqeverisjes vendore”.*

Ndërkohë, me shkresën nr.135 prot., datë 12.12.2023, me lëndë "Vërtetim" e Shkollës 9-vjeçare "Musine Kokalari", Tiranë, është administruar shkresa nr.91 prot., datë 21.10.2023 datë 21.10.2022 me lëndë: "Përcjellje e dosjeve të aplikimit për bursa të nxënësve të shkollës "Musine Kokalari", për vitin shkollor 2022-2023", drejtuar Bashkisë Tiranë, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social, me anë të cilës janë përcjellë dokumentacioni dhe emrat përkatës ku listohen edhe emrat e nxënësve: E. G. Z (nr.22) dhe E. G. Z (nr.29).

³ (xhaxhai i femijëve)

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

Subjekti ankues, është caktuar, kujdestare e fëmijëve të mitur (nipi dhe mbesa e saj), E dhe E. Z, të cilët kanë qenë përfitues të bursës për vitin 2021-2022, për kriterin 2.3/b "Nxënësit që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate" të parashikuar në VKM në Nr. 511, datë 27.7.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", të ndryshuar.

Ndërkohë ankuesja ka aplikuar për të përfituar këtë bursë dhe për vitin 2022-2023, me të njëjtin dokumentacion, kriter dhe kushte, por fëmijët nuk rezultuan përfitues, me pretendimin nga Bashkia Tiranë që numri i aplikantëve që plotësojnë kriteret ishte më i lartë se numri i kuotave të vëna në dispozicion nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

E drejta për arsim, është një e drejtë kushtetuese, e cila duhet të sigurohet mbi baza të barabarta dhe pa diskriminim. E drejta për arsim garantohet edhe në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat vendi ynë i ka ratifikuar duke u bërë kështu pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe të detyrueshme për t'u zbatuar.

Kështu, në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:

1. *Kushdo ka të drejtën për arsimim.*
2. 3. 4.
5. *Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.*

Fëmija si çdo qenie njerëzore është bartës i të drejtave dhe si i tillë ka të drejtën për t'u arsimuar. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, e cila është ratifikuar nga vendi ynë, sanksionin të drejtën e fëmijës për t'u arsimuar mbi bazën e mundësive të barabarta.

Në nenin 28 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës⁴, parashikohet se:

1. *Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata:*

a) *Bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë;*

e) *Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.*

Neni 29

1. *Shtetet Palë u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim:*

⁴ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin 7531, datë 11.12.1991

(a) Të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës;

(b) Të rrisë respektin për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara.

Ligji 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsimim, sanksionon se, e drejta për arsimim garantohet pa u diskriminuar. Çdo nxënësi duhet t’i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.

Kështu, në ligjin 69/2012, parashikohet se:

Neni 5. E drejta për arsimim.

- 1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.*
- 2. Në shkollat publike arsimit të detyrueshëm dhe arsimit të mesëm të lartë janë falas.*

Neni 6. Parime të përgjithshme.

- 4. Në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve.*
- 5. Çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.*
- 6. Nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj.*

Neni 19. Përkujdesje për kategori të veçanta të nxënësve.

Kategorive të veçanta të nxënësve u sigurohet kujdes i posaçëm nga shteti. Format dhe kriteret e përkujdesjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28. Njësia bazë e qeverisjes vendore.

- 1. Njësia e vetëqeverisjes vendore, mbështetur në propozimet e institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe këshillat e mësuesve të institucioneve, sipas kriterëve të miratuara në këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, mbështet: a) nxënësit e familjeve në nevojë; b) nxënësit me arritje të shkëlqyera; c) punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës; ç) pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore; d) nxënësit me aftësi të kufizuara.*

Në zbatim dhe të legjislacionit të sipërcituar, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, e ndryshuar.

Në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohej se:

2. *Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kritereve, si më poshtë vijon:*

2.1 Kriteri ekonomik:

a) *nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët ndjekin procesin mësimor në largësinë mbi 5 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre, që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe që akomodohen në konvikte publike;*

b) *nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët banojnë në zonat rurale që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km, të cilët plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, dhe që akomodohen në konvikte publike;*

c) *nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, me ndikim në uljen e nivelit të “braktisjes shkollore”, që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë.*

2.2 Kriteri i rezultateve të arritura:.....

2.3 Kriteri joekonomik:

a) *nxënësit, të cilët kanë përfituar statusin e jetimit;*

b) *nxënësit, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë;*

c) *nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik;*

ç) *nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë;*

d) *nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit;*

dh) *nxënësit e pakicës kombëtare romë dhe egjiptiane, të cilët regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional;*

e) *nxënësit, të cilët janë identifikuar dhe trajtuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror;*

ë) *nxënësit, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, Forcave të Armatosura, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;*

f) *nxënëset (vajza), të cilat ndjekin drejtimet mësimore mekanikë, elektroteknikë, elektronikë, përpunim druri, gjeodezi, shërbim mjete transporti, termo-hidraulikë;*

g) nxënësit me një prind.

Në fillim të çdo viti shkollor, por jo më vonë se muaji nëntor i çdo viti, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe institucionet e përkujdesjes sociale rezidenciale publike, për këto kategori nxënësish, duhet të dërgojnë në institucionet arsimore ku ata ndjekin procesin mësimor si dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse listën e nxënësve përfitues sipas pikës 2.3 të këtij vendimi.

Qëllimi i përbashkët i akteve ligjore dhe nënligjore të sipërpërmendura është që nëpërmjet tyre të garantohet e drejta e fëmijës për arsim.

Komisioneri konstaton se nxënësit E dhe E.Z plotësojnë më shumë se një kriter të pikës 2.3 të VKM-së, duke qenë edhe nxënës me një prind sipas kriterit 2.3/g, përveç kriterit në të cilin i ka përfshirë Bashkia Tiranë atë të 2.3/b.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka konstatuar se nga ana e Bashkisë Tiranë është pretenduar që shkak i mospërfitimit është që numri i kuotave të vëna në dispozicion nga Ministria e Arsimit dhe Sportit ishte më i vogël se numri i përfituesve që plotësonin kriteret e përfitimit të saj.

Komisioneri vlerëson se për sa kohë aplikuesit plotësonin të gjitha kriteret ligjore të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe i garanton atyre të drejtën për përfitimin e kësaj burse, pretendimi i institucioneve për mospasjen e fondeve në dispozicion për ti garantuar këtë të drejtë i ngarkon ata me përgjegjësi që s'mund të justifikohet.

Në VKM nr.666, datë 10.10.2029 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitime bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet publike”, i ndryshuar me VKM nr.511, date 27.07.2022 pika 10 parashikohet se: “Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar, si dhe ofruesit e arsimit të mesëm profesional publik për zbatimin e këtij vendimi.

Sa më sipër, institucionet qendrore dhe ato vendore duhet të bashkëpunonin me njëra tjetrën për të bërë të mundur plotësimin e parashikimeve ligjore sa i takon çështjes objekt ankese, pasi kjo problematikë sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Bashkisë Tiranë ekziston dhe për një numër të konsiderueshëm aplikantësh të tjerë që plotësonin kriteret ligjore dhe që iu është mohuar kjo e drejtë.

Komisioneri konstaton që përveç Bashkisë Tiranë dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk ka ndërmarrë masa konkrete për zgjidhjen e kësaj situatë dhe pse Bashkia ia ka përcjellë këtë shqetësim.

Ministria e Arsimit dhe Sportit është shprehur që duhet nga ana e Këshillit Bashkiak Tiranë, të merren masa për zgjidhjen e këtij problemi, por referuar VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar, kjo është një bursë e cila ofrohet nga ana e MAS.

Sipas pikës 30 Në VKM nr.666, datë 10.10.2029, ndryshuar me VKM nr.511, date 27.07.2022: *“Ministria përgjegjëse për arsimin, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar, të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, pa përfshirë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale, jep jo më pak se 1200 (një mijë e dyqind) bursa.”*

Pyetur nga Komisioneri nëpërmjetë korespondencës shkresore, por dhe gjatë seancës dëgjimore se, a i plotësonin kriteret dhe ishin përfitues dhe për vitin 2022-2023 këta nxënës, Bashkia Tiranë është shprehur që janë përfitues dhe plotësojnë kriteret.

Ndërkohë e pyetur në lidhje me mënyrën e bërjes së përzgjedhjes dhe përfituesve dhe lënia jashtë saj e një pjese të përfituesve, Bashkia është shprehur se:

1- Bashkia e Tiranës ka vijuar me miratimin e listave me 1200 nxënës të arsimit parauniversitar të përgjithshëm në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa, brenda planit të miratuar për vitin shkollor 2022 – 2023, të përzgjedhur në mënyrë rastësore sipas radhës së shqyrtimit dhe vlerësimit të dosjeve të aplikimit.

- Në shkresën me nr.39932/1 prot., datë 20.11.2023, Bashkia Tiranë, është shprehur: *“Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion mbi mënyrën e përzgjedhjes së aplikantëve që plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar bursa, konkretisht si klasifikohet një numër i caktuar dhe lihen veçantë aplikime të tjera, për shkak të kuotave të pamjaftueshme të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, ju sqarojmë se, mënyra e përzgjedhjes ka qenë rendore sipas radhës së shqyrtimit dhe vlerësimit të dosjeve të aplikimit.*

- Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e Bashkisë Tiranë u shpreh se: *“Përzgjedhja e përfituesve është rastësore dhe sipas momentit të hedhjes në database që mban Bashkia në kohën kur ato dërgohen nga shkollat përkatëse. Detyrimi i përfaqësuesve të shkollave lidhet vetëm me mbledhjen e dokumentacionit dhe përcjelljen e tij në njësitë e vetëqeverisjes vendore”.*

Ndërkohë, arsyeja e pretenduar nga Bashkia Tiranë sa më sipër, bie poshtë dhe provohet e kundërta, referuar shkresës nr.91 prot., datë 21.10.2023 të Shkollës "Musine Kokalari", drejtuar Bashkia Tiranë, me lëndë: "Përcjellje e dosjeve të aplikimit për bursa të nxënësve të shkollës "Musine Kokalari", për vitin shkollor 2022-2023", pasi nga ana e Komisionerit konstatohet se, në emrat e shpallur fitues sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr.172, datë 24.12.2021 "Për miratimin e listave të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa dhe pagesa, për vitin shkollor 2021-2022", kanë rezultuar përfitues edhe disa nga emrat e dërguar nga shkolla me të njëjtën listë me të cilën janë dërguar emrat e E dhe E. Z.

Pra sa më sipër, Komisioneri konstaton se, nxënësit E dhe E. Z, janë në të njëjtën listë që ka dërguar shkolla, me nxënës që rezultojnë që kanë përfituar bursë, pra bie poshtë pretendimi i Bashkisë se përzgjedhja varet nga koha kur shkolla e dërgon listën.

Për sa më lart, Komisioneri arrin në përfundimin se, mospërfshirja e emrave të fëmijës E. G. Z dhe E. G. Z, në listën e përfituesve të bursës për vitin shkollor 2022-2023 nga ana e Bashkisë Tiranë, i ka ekspozuar ata ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, duke iu mohuar e drejta për të përfituar këtë bursë sipas kriterit 2.3/b *"Nxënësit që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate"* të Vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave *"Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, të ndryshuar"*.

Gjithashtu Komisioneri arrin në përfundimin se, për arsye se nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, nuk është ndërmarrë asnjë veprim për zgjidhjen e situatës jo vetëm për vitin mësimor 2022-2023 por edhe pasi është ngritur ky shqetësim nga ana e Bashkisë Tiranë dhe për vitin 2023-2024, nxënësit E. G. Z. dhe E. G. Z, janë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga MAS, duke iu mohuar e drejta për të përfituar këtë bursë sipas kriterit 2.3/b *"Nxënësit që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate"* të Vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave *"Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, të ndryshuar"*.

B. Shkaku i mbrojtur.

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 18 (2)), askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), garanton të drejtën për të mos u diskriminuar bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë mbrojtjen nga disriminimi për shkaqe si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Ligji nr. 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, i ndryshuar, rregullon në mënyrë të drejtëpërdrejtë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të gjendjes familjare dhe përkatësisë prindërore, të pretenduar nga pala ankuese si shkaqe diskriminuese, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : *"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore,*

gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Në rastin në fjalë, pretendohet se nxënësit E dhe E. Z janë, diskriminuar për më shumë se një shkak dhe konkretisht, për shkak të *përkatësisë prindërore* dhe *gjendjes familjare*.

Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se shkakun e pretenduar prej saj është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak.

Komisioneri konstaton se, shkakun e *gjendjes familjare*, i pretenduar si shkak diskriminimi nga pala ankuese, ka në bazë të tij shkakun që fëmijët, në mungesë të njërit prind, si dhe prindit tjetër në burg, janë në kujdestarinë e gjyshes së tyre, kriter në bazë të të cilit fëmijët rezultojnë përfitues sipas VKM-së nr. 666/2019.

Referuar certifikatës së gjendjes familjare të datës 27.07.2021, fëmijët e mitur E dhe E. Z figurojnë të regjistruar si pjestarë të familjës, e cila përbëhet prej 4 personash, gjyshi, gjyshja, nipi dhe mbesa. Në bazë të certifikatës së vdekjes datë 21.10.2019, rezulton që nëna e dy fëmijëve të mitur Morena Vrapit ka vdekur në datën 09.10.2018.

Sipas të dhënave të përshkruara në Vendimin nr.7719 datë 24.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, citohet se G. Z, babai i fëmijëve të mitur E dhe E. Z rezulton me masë sigurimi personal "Shtrim i përkohshëm", në spitalin psikiatrik, për shkak të problemeve të shëndetit mendor.

Sipas Komisionerit, *gjendja familjare*, ka të bëjë me marrëdhëniet, farefisnore ose prindërore të cilat një person ka me persona tjerë. Gjendja familjare ose martesore mund të ndryshojë ndërmjet individëve, pasi ata mund të jenë të martuar ose jo, në një marrëdhënie de facto ose në një marrëdhënie që nuk e njej ligji, të divorcuar ose të ve, jetojnë në një familje të zgjeruar ose kanë përgjegjësi të ndryshme për fëmijët dhe personat e varur ose një numër të caktuar fëmijësh.....⁵

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak "*të përkatësisë prindërore*", subjekti ankues e lidh me faktin që G. Z, babai i fëmijëve të mitur E dhe E. Z rezulton me masë sigurimi personal "Shtrim i përkohshëm", për shkak të problemeve të shëndetit mendor.

⁵ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

Sipas Komisionerit shkaku i "përkatësisë prindërore", nënvizon faktin se, diskriminimi mund të ndodhë kundrejt një personi duke e identifikuar atë me prindërit e tij/saj, apo me statusin e prindërve të tij. Për këtë arsye dikush diskriminohet, jo për një shkak të mbartur nga ai vetë, por për një shkak që identifikohet me përkatësinë e tij prindërore. Këtu përfshihet edhe prejardhja, veçanërisht lidhur me përkatësinë në një shtresë sociale apo çdo lloj statusi të trashëguar.⁶

Sa më sipër, Komisioneri kostaton që fëmijët në kujdestari të ankueses i mbartin shkaqet e diskriminimit të pretenduar në kuptim të ligjit nr.10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar.

C. Lidhja e trajtimit të pafavorshëm me shkaqet e mbrojtura.

C.1 Lidhja e trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm, me shkakun e gjendjes familjare.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar, si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Neni 18, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet ky parim parashikon: "1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive".

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: "Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta", si dhe "Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përlligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë" (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me "gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji" dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se "diskriminimi" do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në

⁶ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁷. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme⁸. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14 nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar “pabarazitë faktike” ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14⁹.

Në nenin 3, pika 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD, përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përlegjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku sanksionohet se : “*7/1. Në rastet kur pala ankuuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim*”. Një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit parashikohet nga Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 82, pika 2, të të cilit, përcaktohet si vijon: “*2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”.

⁷ Shih: Çështja Thlimmenos kundër Greqisë [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

⁸ Shih: Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

⁹ Shih: Çështjen Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen Thlimmenos, cituar më lart, prg. 44; Çështjen D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni e ka zhvendosur barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se prima facie është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, fillimisht duhet të krijohet një prezumim i diskriminimit (diskriminimi prima facie), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njëren nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminim.¹⁰

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standartin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtuara në këtë ankesë.

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm në bazë të të cilit fëmijët rezultojnë përfitues dhe faktit që:

- Fëmijët plotësonin më shumë se një kriter të VKM-së nr. 666/2019;
- Fëmijët për vitin 2021-2022 e kanë përfituar bursën sipas kriterit 2.3/b të VKM-së dhe rezultojnë që vijojnë të mbartin kriterin në bazë të të cilit kanë rezultuar përfitues.
- Fëmijët për vitin 2022-2023, kanë aplikuar brenda afateve ligjore, me të njëjtin shkak.

fëmijët nën kujdestari të subjektit ankues, nuk kanë përfituar bursën sipas kriterit 2.3/b të VKM-së.

Në analizë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit të nxënësve E Z. dhe E. Z, në lidhje me mosdhënien e bursës për vitin shkollor 2022-2023, nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit edhe pse plotësojnë kriteret sipas VKM-së nr.666/2019 dhe si pasojë barra e provës bie mbi këtë subjekt.

Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, Bashkia Tiranë dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të përmbushnin dy kushtet e përmendura më sipër.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

¹⁰ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

- Komisioneri gjeti një diferencim në trajtim të nxënësve E. Z dhe E. Z edhe me nxënësit përfitues, emrat e të cilëve ndodheshin në të njëjtën listë të dërguar nga shkolla, duke hedhur poshtë pretendimin e Bashkisë se përzgjedhja e fituesve varet nga koha kur shkolla e dërgon listën.
- Nga ana e Bashkisë Tiranë, në cilësinë e pushtetit vendor, nuk është vënë në dispozicion asnjë informacion apo provë lidhur me hapat e ndërmarrë për zgjidhjen e problematikës për nxënësit që plotësonin kriteret për vitin shkollor 2022-2023, por që nuk rezultuan përfitues për arsye të mungesës së kuotave të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
- Bashkia Tiranë për vitin shkollor 2023-2024 u shpreh se edhe këtë vit numri i aplikantëve që plotësonin kriteret ishte më i lartë se numri i kuotave të vëna në dispozicion nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, por që ajo do ti plotësojë nga buxheti i saj. Bashkia Tiranë nuk ofroi asnjë shpjegim objektiv dhe të arsyeshëm se pse një veprim të tillë nuk e ndërmori dhe për vitin paraardhës (2022-2023)
- Gjate seancës dëgjimore të zhvilluar nga Komisioneri gjatë shqyrtimit të ankesës nr. 134, datë 29.06.2023, e Qendrës për Advokim Social në cilësinë e përfaqësueses së një grupi nxënësish, kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë Tiranë me pretendimin për diskriminim, për shkak të *racës, ngjyrës, etnisë, gjendjes ekonomike, gjendjes arsimore, gjendjes familjare dhe përkatësisë në një grup të veçantë*, përfaqësuesja e Bashkisë Tiranë, znj. A. L ndër të tjera parashtrroi: “VKM¹¹ ka një dhe një specifikë. Ai që ka përfituar një vit përpara është vazhdues i përfitimit sepse nuk i ndryshon gjendja. Psh, fëmijët që jetojnë me një prind gjallë nuk i ndryshon statusi dhe ata janë automatikisht fitues dhe ti e ke të pamundur si organ zbatues që të bësh një lloj përzgjedhje në këtë rast sepse ti e ke numrin statik tashmë...”¹²
- Komisioneri vlerëson se Bashkia Tiranë nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim në rastin objekt shqyrtimi pasi fëmijët për vitin 2021-2022 e kanë përfituar bursën sipas kriterit 2.3/b të VKM-së dhe rezulton që vijnë të mbartin kriterin në bazë të të cilit kanë rezultuar përfitues, gjithashtu janë njëkohësisht edhe fëmijë me një prind duke i përjashtuar ata nga e drejta e përfitimit të bursës.
- Pretendimi i Bashkisë se fëmijet janë përjashtuar nga e drejta e bursës për shkak se numri i kuotave të dërguara nga Ministria është më i ulët se numri i përfituesve nuk qëndron në këtë rast pasi fëmijet janë në të njëjtën gjendje si një vit më parë dhe duhet të vijonin të ishin përfitues. Bashkia nuk solli pranë Komisionerit fakte dhe prova që të justifikojë veprimet e saj.
- Sipas pikës 30 Në VKM nr.666, datë 10.10.2029, ndryshuar me VKM nr.511, date 27.07.2022: “Ministria përgjegjëse për arsimin, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar, të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, pa

¹¹ VKM-së nr. 666/2019, në vitin 2022, i ndryshuar

¹² Referuar audio seancës dëgjimore datë 05.10.2023, ankesës nr. 134, datë 29.06.2023

përfshirë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale, jep jo më pak se 1200 (një mijë e dyqind) bursa.”

- Nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, nuk është ndërmarrë asnjë veprim për zgjidhjen e situatës jo vetëm për vitin mësimor 2022-2023 por edhe pasi është ngritur ky shqetësim nga ana e Bashkisë Tiranë dhe për vitin 2023-2024, nxënësit E. G. Z dhe E. G. Z, janë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga MAS, duke iu mohuar e drejta për të përfituar këtë bursë sipas kriterit 2.3/b *"Nxënësit që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë" të Vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, të ndryshuar".*

Komisioneri vlerëson se nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk u arrit të provohej:

1. Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, dhe trajtimit të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.
2. Që veprimet dhe mosveprimet e Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit kundrejt subjektit ankues, kanë një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Komisioneri vlerëson se, qëllimi i VKM-së nr. 666/2019, në vitin 2022, i ndryshuar, është ndër të tjera të mbështesë financiarisht, kategori përfituese të veçantë, familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe familjet që kanë të ardhura nën pagën minimale, përfshirë edhe fëmijët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim të formës së prerë, nxënës me një prind, në mënyrë që këtyre fëmijve tu garantohet e drejta për arsimim.

E drejta për arsim, është një e drejtë themelore e njeriut, e sanksionuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Shteti ka detyrimin që jo vetëm ta parashikojë, por edhe ta përmbushë këtë të drejtë duke e garantuar atë. Detyrimi për të përmbushur do të thotë që shteti duhet të marrë masa pozitive për të siguruar dhe lehtësuar gëzimin e të drejtave, sidomos për grupet shoqërore më të pamundura, të cilat në të kundërt, nuk do të kenë mundësi të kenë qasje në regjistrimin apo ndjekjen e arsimit.

Fëmija si çdo qenie njerëzore është bartës i të drejtave dhe si i tillë ka të drejtën për t'u arsimuar. Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës, e cila është ratifikuar nga vendi ynë, sanksionon të drejtën e fëmijës për t'u arsimuar mbi bazën e mundësive të barabarta dhe shtetet palë duhet të marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

Ligji 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsimim, sanksionon se, e drejta për arsimim garantohet pa u diskriminuar. Çdo nxënësi duhet t’i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, Bashkia Tiranë dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për të garantuar të drejtën për arsim të të gjithë fëmijëve, familjet e të cilëve plotësojnë kriteret respektive të parashikuara në VKM duhet të kishte parashikuar trajtimin me bursë të të gjithë fëmijëve që i plotësonin kushtet për përfitimin e saj.

Pra, ata janë vënë në pozita diskriminuese, për shkak të gjendjes familjare të tyre si fëmijë nën kujdestari.

Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026¹³, ka si vizion të saj: “Sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe i bazuar në parimet e barazisë dhe mësimi gjatë gjithë jetës, që mundëson formimin cilësor të të gjithë individëve, duke kontribuar në mirëqenien personale të tyre, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integritetin e vendit në Bashkimin Evropian”.

Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, ndër objektivat e saj specifike ka parashikuar dhe objektivin specifik A.2, ku citohet: “Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale dhe fizike të të gjithë nxënësve për të ulur braktisjen dhe për t’u mundësuar nxënësve të arrijnë potencialin e tyre të plotë;...”.

Një dokument tjetër dokument strategjik i miratuar nga qeveria shqiptare me VKM-në Nr. 866, datë 24.12.2019, është dhe Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2020-2023. Kjo strategji synon: “... të përmirësojë mirëqenien fizike, shoqërore dhe ekonomike të individëve, fëmijëve dhe familjeve, veçanërisht të atyre në kushte sociale ose ekonomike të pafavorizuara, duke garantuar shanse të barabarta dhe parimet e drejtësisë sociale. Strategjia synon reduktimin e varfërisë, sidomos varfërisë ekstreme, duke garantuar një jetesë dinjitoze për familjet/individin dhe fëmijët. Varfëria do të ulet, duke nxitur zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të tyre nëpërmjet adresimit të nevojave në kontekstin e rehabilitimit, integritetit në tregun e punës dhe të shërbimeve shoqërore...

Paketa mbështetëse me subvencione shtesë/bonuse për vaksinimin dhe arsimimin e fëmijëve, si dhe ofrimi i paketës së ndihmës në natyrë tregon vëmendjen e shtuar për të asistuar familjen në tërësi duke integruar të gjitha llojet e shërbimeve publike...”¹⁴.

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështje dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, rezultoi se, pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që nxënësit i sigurohet e drejta për arsimim cilësor dhe mundësi të barabarta, nxënësit e familjeve në nevojë dhe atyre me vështirësi u ofrohet kujdes i veçantë nga shteti, duke përfituar lehtësira në

¹³ Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 621, datë 22.10.2021.

¹⁴ Paragrafi i 2,3 dhe 5 i cituar në faqen 2 të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020-2023.

ushqim, mensa, bursa financiare, rezultoi që nxënësit E dhe E. Z në kujdestari të subjekti ankues, nuk kanë përfituar këtë bursë, e cila iu njihet sipas akteve në fuqi.

Megjithatë, duke mbajtur në konsideratë detyrimin dhe përgjegjësitë e shtetit për të vënë në dispozicion fonde publike për të garantuar aksesin në arsimin e lartë, sipas meritës, pavarësisht nga mundësitë financiare të individëve, Komisioneri thekson se, vendosja e një sistemi të përshtatshëm bursash, përbën një nga mjetet për të siguruar realizimin e plotë dhe në baza të barabarta për të gjithë të të drejtës për arsim.

Nga ana e Bashkisë Tiranë, për nxënësit që plotësonin kriteret për vitin shkollor 2022-2023, por që nuk rezultuar përfitues të bursës, nuk është vënë në dispozicion asnjë informacion apo provë lidhur me hapat e ndërmarrë për zgjidhjen e kësaj situatë konkrete nga ana e saj, në cilësinë e pushtetit vendor dhe politikave të saj sociale.

Bashkia Tiranë për vitin shkollor 2023-2024 u shpreh se dhe këtë vit numri i aplikantëve që plotësonin kriteret ishte më i lartë se numri i kuotave të vëna në dispozicion nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, por që ajo do të plotësojë nga buxheti i saj, veprim të cilin nuk e ndërmori dhe për vitin paraardhës.

Bazuar në tërësinë e fakteve dhe provave të administruara në lidhje me rastin konkret të znj. Mbaresë Zika, Komisioneri vlerëson se Bashkia Tiranë dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk arritën të provojnë dhe të jepnin një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i janë nënshtruar nxënësit E dhe E. Z.

Sa më sipër, rezulton plotësisht e provuar lidhja shkakësore midis shkakut të mbrojtur, që në rastin konkret është *gjendja familjare* si fëmijë nën kujdestari dhe trajtimit të pafavorshëm dhe të pabarabartë, të cilit i janë nënshtruar nxënësit E dhe E. Z.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mospërfitimi i bursës për vitin shkollor 2022-2023 të fëmijëve E dhe E. Z, si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, i ka ekspozuar ata ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, duke iu mohuar e drejta për të përfituar këtë bursë sipas kriterit 2.3/b "Nxënësit që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate" të Vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, i ndryshuar", për shkakun e diskriminimit të pretenduar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit nr.10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, përcaktohet se: "Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre", ndërsa në nenin 33, pika 12, përcaktohet se : "Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës".

Ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 33/10, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit. Ky ligj, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese është marrja e masave nga ana e institucioneve përgjegjëse, që të sigurojnë dhënien e tarifës së bursës së mohuar për vitin shkollor 2022-2023.

Sa i takon shkakut të *përkatësisë prindërore*, si shkak diskriminimi të pretenduar nga pala ankuese Komisioneri nuk gjeti fakte dhe prova në bazë të të cilëve të prezumojë sjellje diskriminuese nga Bashkia Tiranë.

Gjithsesi Komisioneri vlerëson që Bashkia Tiranë dhe Ministrisa e Arsimit dhe Sportit duhet të ketë parasysh këto kategori fëmijësh, të cilët ndodhur në kushtet e mungesës së një prindi si dhe me prindin tjetër në burg, ndodhen në kushte më vulnerabel, për t’u siguruar si të gjithë fëmijëve, të drejtën për arsimim dhe barazi.

Gjithashtu Komisioneri vlerëson që Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të marrë masa konkrete për të bashkëpunuar, koordinuar dhe konsultuar me pushtetit vendor, gjatë procesit të hartimit të kuotave në propocion me nevojat e bashkive, për vlerësimin dhe zgjidhjen e këtyre problematikave për të shmangur situata të tilla dhe për të rregulluar sjellje të tilla diskriminuese.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 1, nenin 7/1, nenin 11, nenin 32, pika 1, germa b) e nenin 33, pikat 10-11, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të nxënësve E. Z dhe E. Z, nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë e Arsimit dhe Sportit për shkak të *gjendjes familjare* si fëmijë nën kujdestari.
2. Bashkia Tiranë, të marrë masa, për dhënien e tarifës së bursës për vitin 2022-2023 sipas kriterit të parashikuar në VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të

pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.

3. Ministria e Arsimit dhe Sportit të marrë masa konkrete për sigurimin e numrit të kuotave të nevojshme gjatë hartimit të planit të tyre, për çdo bashki.
4. Për të shmangur situatën e krijuar në rasin konkret, rekomandohet Bashkia Tiranë dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, të marrin masa, për një bashkëpunim më intensiv dhe të frytshëm, për koordinimin dhe konsultimin mes pushtetit vendor dhe atij qendror, gjatë procesit të hartimit kuotave në propocion me nevojat e bashkisë.
5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijëni për këtë vendim, Bashkia Tiranë dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat konkrete të marra për zbatimin e këtij vendimi.
6. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA